



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Zyra e Prokurimit**

**Dt. 19.04.2023**

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 28 të Kushtetut të Kosovës dhe të Kushtetut të Kosovës të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-22-5711-1-3-6, numër të brendshëm 632-22-047-136 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17954, për shkak të mos-përbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Furnizuesit: TIMEPROJECT SH.P.K., me seli në Prishtinë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 19.04.2023, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

**VENDIM**

**Për ndërprerjen e Kontratës**

1. Për shkak të dështimit për të përbushur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, Kontrata me numër të prokurimit: 632-22-5711-1-3-6, numër të brendshëm 632-22-047-136 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17954, e datës 15.07.2022, për realizimin e kontratës : "Furnizimi dhe montimi i xhamave në shkollë", e lidhur me në mes të AK Komuna e Gjakovës dhe OE " TIMEPROJECT " SH.P.K me seli në Prishtinë, NDËRPRITET.
2. Për shkak se Furnizuesi " TIMEPROJECT " SH.P.K, me seli në Prishtinë, është përgjegjës për mos përbushje të obligimeve që dalin nga kontrata, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, NDËRPRITEN së vepruari të gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Furnizues, të rregulluara me Kontratën me numër të prokurimit: 632-22-5711-1-3-6, numër të brendshëm 632-22-047-136 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17954, e datës 15.07.2022, për çka Autoriteti Kontraktues, do të kërkojë zbatim të penaleve për kompensimin e dëmit të shkaktuar.
3. Me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga veprimet e pajustificuara të Furnizuesit, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

**A r s y e t i m**

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Blerësit, ka iniciuar aktivitetin për "Furnizimi dhe montimi i xhamave në shkollë", të dt. 15.07.2022, me O.E : " TIMEPROJECT SH.P.K., me seli në Prishtinë, për kryerjen e furnizimeve të kontraktuara sipas Kontratës.

OF KOSOVA\*REPUBLIC  
Kosovo  
Kosovo

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 01nr.112/02-17926 të dt. 15.07.2022, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejte te Menaxherit të Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike ne Zyrën e Prokurimit me date 13.04.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen e Kontratës për mos realizim te kontratës konforme kushteve të kontratës.

Me date 18.04.2023, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ne përputhje me nenin 28 te Kushteve te Përgjithshme të Kontratës (KPK) ka dorëzuar "Njoftimin për shkëputje te kontratës" te OE: " TIMEPROJECT SH.P.K., me seli në: Prishtinë.

Duke qenë se Furnizuesi: " TIMEPROJECT SH.P.K., me seli në Prishtinë, në vazhdimësi, nga dt.09.03.2023 e deri më sot, dt. 19.04.2023, nuk është përgjigjur pozitivisht në kërkesat e AK Komuna e Gjakovës , për të sjellë gjithë mallin sipas kërkesave teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit , këto veprime të Furnizuesit, nga ana e AK Komuna e Gjakovës , janë vlerësuar të paarsyeshme, prandaj kontrata ndërpritet duke u bazuar ne nenin 28.1, paragrafët, a, b dhe c te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, AK Komuna e Gjakovës , përfundimisht ka vlerësuar se Furnizuesi TIMEPROJECT SH.P.K., me seli në: Prishtinë, duke mos zbatuar kërkesat e AK Komuna e Gjakovës, për zbatim të plotë të kontratës, është përgjegjës për shkak të dështimit të tij për të liferuar mallin e kontraktuara konform kërkesave dhe Specifikave Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit, që për pasojë ka mos përmbushjen e plotë të kontratës së furnizimit.

Andaj, për arsytet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave te Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës

Eaton Gutaj

Zyrtar përgjegjës i prokurimit

#### Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Drejtorisë për Arsim;  
Drejtorisë për Buxhet dhe financa  
Menaxherit të kontratës;  
Arkivës së Komunës.